

KRITERET PËR SHKRIMIN E ABSTRAKTIT

1. TITULLI

Titulli duhet të shkruhet në formatin **BOLD**, në gjuhën shqipe dhe në atë angleze.

2. AUTORËT

Pas titullit shkruhen emrat e autorëve bashkë me pozicionet përkatëse akademike ose profesionale.

Të përcaktohet referuesi i temës me shenjën *.

3. HYRJA DHE QËLLIMI

Të përshkruhet qëllimi i kërkimit shkencor ose profesional, pikat e interesit dhe të përcaktohet rëndësia e tyre.

4. METODOLOGJIA

Në këtë paragraf duhet të përcaktohet nëse studimi është retrospektiv / prospektiv, analitik, kuantitativ apo çdo mënyrë tjetër e zgjedhur prej jush. Të përcaktohen elementët (nëse ka) si kohëzgjatja, numri i rasteve të përfshira në studim dhe mënyrën se si u përzgjedhën ato. Si u përpunuan të dhënat për të arritur tek rezultatet.

5. REZULTATET

Ky është një nga paragrafët më të rëndësishëm që përmbledhin rezultatet e punës gjatë kërkimit shkencor. Duhet të raportohen vetëm të dhënat që kanë të bëjnë me objektivat. Çdo konkluzion statistikor duhet të detajohet mjaftueshëm për të bërë vlerësimin e interpretimit të të dhënave. Kjo përfshin prezantimin numerik nga përgjigjet eksperimentale. Një tabelë e thjeshtë ilustruese (jo më shumë se 1 tabelë) mund të përdoret nëse kjo është metoda më efektive për të përçuar rezultate të qarta.

6. PËRFUNDIMET

Thelbi i përfundimit është t'i përgjigjet në mënyrë preçise dhe statistikisht korrekte pyetjes apo qëllimit të parashtruar në fillim të abstraktit. Përfundimi i arritur duhet të bazohet në rezultatet e paraqitura në abstrakt.

7. FJALËT KYÇE

3-10 fjalë që përfaqësojnë pikat kyçe të studimit.

8. BIBLIOGRAFIA

Duhet të jetë kryesisht e 5 viteve të fundit, në përputhje me standardet e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Kujdesin Shëndetësor dhe Shoqëror.

- Abstrakti duhet të ketë një numër minimal prej 250 fjalësh dhe maksimal prej 400 fjalësh.
- Shkrimi i përdorur duhet të jetë Times New Roman 12.
- Abstrakti dorëzohet në shqip dhe në anglisht.
- Autorët në momentin e dërgimit të abstraktit duhet të specifikojnë fushën osë fushat në të cilat bën pjesë studimi, duke u bazuar në tematikat e mëposhtme:

1. Farmaci e rrjetit të hapur
2. Farmaci spitalore
3. Farmaci industriale dhe përgatitje galenike
4. Kozmetikë
5. Legjislacion dhe etikë farmaceutike
6. Edukim farmaceutik
7. Bioteknologji farmaceutike
8. Kërkim në shkencë farmaceutike
9. Farmacia dhe Covid-19
10. Ushqimi, nutricion, doping në sport dhe shëndeti
11. Sistemi rregullator në farmaceutikë
12. Farmakovigjilencia
13. Farmakoekonomia dhe utilizimi i barnave
14. Menaxhimi dhe marketingu farmaceutik

Gjithashtu, autorët janë të lutur të sjellin një abstrakt të zgjeruar (2 – 4 faqe A4, Times New Roman 12, normal margins). Këto abstrakte të zgjeruar do të botohen si proceedings të konferencës, në një suplement të veçantë të revistës “New Bulletin of Medical Sciences”, Botim i Fakultetit të Mjekësisë, ISSN online: 2521-0327, ISSN print: 2521-0319. Abstrakti i zgjeruar mund të jetë në shqip ose në anglisht.

Lutemi që abstraktet e temave të na i dërgoni në adresën e e-mailit: edukimnevazhdim@ufsh.org.al brenda datës 05 shtator 2022.